

Thirrje për Praktikantë në Agro Victus Farming

AgroVictus Sh.p.k është kompania e parë agro-urbane dhe agro-teknologjike në Prishtinë, Kosovë e specializuar në prodhimin e ushqimit në hapësira të mbyllura dhe struktura vertikale, të kontrollueshme, dhe të bazuara në principet e ekonomisë qarkore duke shfrytëzuar mbeturina organike dhe duke i kthyer ato në delikatesa të ndryshme. Ne synojmë të kontribuojmë në shoqërinë tonë me burime të qëndrueshme të ushqimit dhe produkte tjera organike, nëpërmjet metodologjive të prodhimit që janë miqësore ndaj mjedisit dhe në të njëjtën kohë frymëzojmë shoqërinë tonë drejt dietave të shëndetshme dhe një të ardhme neutrale të karbonit.

Në qershor 2018 kemi startuar fermën e pare urbane prej 200m2 në një lagje të urbanizuar të Prishtinës, ku edhe prodhojmë gjatë gjithë vitit produkte unike në vend si kërpudhat ekzotike dhe melmesa të freskëta, produkte të procesuara, vecanërisht produkte që rrallë gjenden në tregun vendas përveç importeve të rralla. Ne duam ta mbushim këtë boshllëk, me një koncept “prej-fermës-në-pjatë” duke ofruar dërgesë në të njëjtën ditë të vjeljes dhe kjo siguron rendiment të freskët tek klientët tonë. Prodhimi ynë sjell çdo ditë ushqime me vlera të larta dhe proteina të qëndrueshme që njëherit përfaqëson vlerat më të mira të prodhimit vendas dhe devijon në mënyrë aktive mbeturinat organike nga deponitë e mbeturinave si dhe redukton emitimin e dioksidit të karbonit nga djegja e biomasës për qëllim të nxemjes, etj. Ne besojmë se Kosova ka te gjitha parakushtet për tu bërë e vete-qëndrueshme sa i përket furnizimit të nevojës ushqimore në vend dhe jemi të përkushtuar ta arrijmë këtë para vitit 2030.

DETYRAT DHE PERGJEGJSITE SPECIFIKE

Në mbështetje të stafit tjetër, praktikantët do të jenë përgjegjës për të ndihmuar në të gjitha detyrat e fermes urbane siç janë caktuar për të maksimizuar prodhimin. Detyrat specifike përfshijnë:

-Organizimin e substratit

-Miksimin e substratit

-Përgaditjen e blloqeve

-Sterilizimin e blloqeve

-Inokulimin e blloqeve

-Organizimin e blloqeve në dhomen e inkubimit

-Organizimin e blloqeve në dhomen e frytëzimit

-Vjelje

-Klasifikimi i produkteve dhe paketimi

-Monitorimi dhe mbajtja e shënimeve

-Mbjellja e fidaneve

-Organizimi i bimëve

-Mirembajtja e fermës

-Marketing

-Detyra tjera që mund të lindin gjatë procesit të punës

KUALIFIKIMI

Edukimi: Një student në vitin e dytë, të tretë, ose vitin e fundit të studimeve të diplomës bachelor ose të diplomuar në Bujqësi, Ekologji, Zhvillim të Qendrueshëm, Megatronike, Sisteme Informacioni, Marketingu ose fusha të ngjashme.

Gjuha: Rrjedhshmëri e gjuhës shqipe. Njohja e gjuhës angleze është përparsi

Shkathtësi kompjuterike: Përvojë e mire në përdorimin e kompjuterëve dhe aplikacioneve të ndryshme të zyrës si Microsoft Office, Google Drive, etj

Shkathtësitë ndërpersonale: Aftësia për të punuar në mënyrë profesionale, konstruktive dhe bashkëpunuese si pjesë e ekipit, për të përmbushur afatet, për të komunikuar në mënyrë efektive dhe për t'u marrë me partnerë të ndryshëm në një mjedis sfidues.

Vetë-motivim dhe udhëzim: Iniciativë e fortë individuale dhe aftësi për të menaxhuar aktivitetet e përditshme dhe për të arritur rezultatet e pritura.

KUSHTET E PERGJITHSHME

Kandidatët potencial duhet të jenë në gjendje të punojnë 3-5 ditë në javë / 4-8 orë në ditë (angazhim prej 80 orësh në muaj) për një periudhë fillestare tre (3) mujore, duke filluar prej shkurtit 2021.

Ju lutemi dërgoni aplikacione elektronike, të përbërë nga CV dhe një letër motivimi në agrovictus@gmail.com deri më 15 janar 2021 jo më vonë se në ora 16:00. Ju lutemi shënoni titullin: Aplikimi për praktikantë, tek subjekti i emailit. Nuk ka nevojë për thirrje telefonike.

AgroVictus Sh.p.k është një punëdhënës i mundësive të barabarta dhe nuk bën paragjytime në zgjedhjen e saj dhe praktikat e punësimit. Të gjithë aplikantët e kualifikuar do të merren në konsideratë për punë pa marrë parasysh racën, ngjyrën, fenë, seksin, origjinën kombëtare, përkatësinë politike, orientimin seksual, identitetin gjinor, statusin martesor, aftësinë e kufizuar, statusin e mbrojtur të veteranit, informacionin gjenetik, moshën ose karakteristikat e tjera të mbrojtura ligjërisht.